



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
Obaveštajna Agencija Kosova
Kosovo Intelligence Agency



E KUFIZUAR

DATË/A: 27.01.2017

REFERENC-Ë: 01-33 - 2017

PËR/ZA/TO: z. Hashim THAÇI
President i Republikës së Kosovës

z. Isa MUSTAFA
Kryeministër i Republikës së Kosovës

NGA/OD/FROM: Agron SELIMAJ
Drejtor i AKI

TEMA/SUBJECT: Kërkesë për lirim nga detyra

Te nderuar,

Përmes kësaj shkresë ju lutem të pranoni me shumë respekt Kërkesën time për lirim nga detyra e Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Pas një kohe të gjatë (me shumë se 7 vite), po besoj se tani është koha që unë dhe familja ime të fillojmë një kapitull të ri në jetën tonë.

Ka qenë nder dhe privilegj i veçantë të ju shërbej ju z. President Thaçi dhe ju z. Kryeministër Mustafa. Këtë nder dhe privilegj ja dedikoj edhe Presidentes Jahjaga dhe Presidentit Sejdiu. Gjithashtu, falënderoj për bashkëpunim të gjithë anëtarët e Komisionit parlamentar për mbikëqyrjen e AKI.

Këto vitet e udhëheqjes së grave dhe burrave të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë kanë qenë nder vitet me të suksesshme të karrierës time. Çdo ditë që kam kaluar në AKI ka qenë kënaqësi dhe nder për besimin tuaj.

E KUFIZUAR

Faqe 1 nga 2

Puna, angazhimi dhe përkushtimi i punonjësve të AKI ka ofruar ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare të vendit tonë. Jam shumë krenar që kam udhëhequr dhe shërbyer me gratë dhe burrat me të devotshëm të Republikës së Kosovës. Profesionalizimi i tyre ka bërë që vendi jonë të jetë më i sigurt se asnjëherë më parë.

Jam shumë mirënjohës bashkëpunëtorëve me të ngushtë dhe të gjithë kolegëve të AKI të cilët i besuan lidershit tim. Ka qenë kënaqësi të ndihmohem nga çdonjëri prej tyre.

Përmes kësaj shkrese, falënderoj çdonjërin që ka pasur mundësi të punoj personalisht me mua dhe stafin e AKI. Kam pasur kënaqësinë të jem pjesë e ekipit me të privilegjuar dhe të gjithë do të me mungoni.

Ju falënderoj për mundësitë që me ofruat ti shërbej kombit tonë.

Ju uroj sukses në udhëheqjen e shtetit tonë të dashur.

Me respekt,